

Të dhëna bazike të lëndës	
Universiteti:	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj
Njësia akademike:	Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës
Programi:	Informatikë e Aplikuar
Titulli i lëndës:	Aplikimi i TI-së në ndërmarrje
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	II, Semestri IV
Numri i orëve në javë:	3
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	_____
Përshkrimi i lëndës:	<p><i>Kjo lëndë do t'i njoftoj studentet se si Informatika ka sjelle një botë krejt të re të bërit biznes, duke përdorur teknologji inovative të informacionit për menaxhim dhe organizim.</i></p> <p><i>Lënda do t'i ofroj studenteve njohuri gjithëpërfshirëse në teknologjinë e informacionit, të domosdoshme për digjitalizimin e suksesshme të një biznesi, për t'i përgatitur ata për një karriere të suksesshme si pjesë e ndonjë kompanie/organizate.</i></p> <p><i>Studentet gjatë këtij semestri do të njihen me Management Information System(MIS), llojet e ndryshme dhe përdorimi i tyre.</i></p> <p><i>Lënda kombinon njohuritë në biznes, menaxhim, teknologji informacioni dhe koncepte nga shkenca kompjuterike</i></p>
Qëllimet e lëndës:	<p><i>Lënda ka për qëllim të përgatit studentet të njohin rolin dhe rëndësinë e informatikës në biznes, dhe t'i ndihmojë atyre të kuptojnë mundësit e mëdha që ofron informatika në rritje të suksesit dhe efikasitetit të biznesit dhe në rritjen e aftësisë konkurruese.</i></p> <p><i>Informatika në biznes synon që të pajisë të gjithë studentët me njohuritë e domosdoshme në Informatike dhe aplikimin e tyre në punën e një biznesi, me konkretisht t'i njoftojë studentët me Management Information System(MIS), komponentë përbërëse, llojet e Sistemeve të Informacionit dhe përdorimi i tyre.</i></p> <p><i>Dizajnimi konceptual, Implementimi, vlerësimi dhe mirëmbajtja e sistemeve. Identifikimi i problemeve dhe dështimeve në MIS dhe strategjitë për parandalimin e tyre. Digjitalizimi i ekonomisë dhe bizneseve. Inteligjenca biznesore. Tregtia elektronike dhe biznesi elektronik, qeverisja elektronike, etj</i></p>
Rezultatet e pritura të mësimnxënies:	<p><i>Pas përfundimit të lëndës studenti do të jenë në gjendje:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Të kuptojë ndikimin e informatikës në biznes dhe ekonomi,</i> • <i>Të kuptojë rolin dhe rëndësinë e informacionit si produkt të informatikës në marrjen e vendimeve me ndihmën e teknologjisë informative.</i>

	<ul style="list-style-type: none"> • Të njoh Sistemet e informacionit të përdorura sot nga kompanitë e biznesit; strukturën dhe komponentët përbërëse(Teknologjinë e Informacionit dhe të komunikimit(TIK), Njerëzit dhe Proceset) • Të fitojë njohuri të përgjithshme për Harduerin dhe Softuerin, Bazat e të dhënave, Teknologjia e rrjetit dhe telekomunikacionit, Interneti. • Të kuptojë organizimin dhe përdorimin e MIS në funksion të marrjes së vendimeve efektive, respektivisht të zgjidhin probleme të biznesit apo organizatës duke përdorur MIS. 		
Parakushtet:	<i>Njohuri themelore në fushën e biznesit dhe teknologjisë së informacionit</i>		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Aktiviteti	Aktiviteti	Aktiviteti
Mësim teorik dhe praktik	3	15	45
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			
Ushtrime në teren			
Kollokviume, seminare dhe projektet	3	2	6
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgatitja përfundimtare për provim	7	2	14
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz dhe provim final)			
Projektet dhe prezantimet	3	5	15
Totali			125
Metodologjia e mësimdhënies:	<p><i>Ligjërata dhe diskutime në klase si dhe ushtrime praktike me kompjuter, të kombinuara me rishikimin dhe diskutimin e një rasti studimi. Aktivitete dhe hulumtime në grup, projekt kërkimore në teren dhe prezantime.</i></p> <p><i>Do të përdoret projektori për projektim të leksioneve të përgatitura në PowerPoint, ndërsa për veprime praktike do të përdoren mjetet konkrete, si: Kompjuteri, Printeri, Skaneri dhe Interneti.</i></p>		
Metodat e vlerësimit:	<p><i>Studenti mund të zgjedhë të vlerësohet një nga dy format e vlerësimit, të dhëna më poshtë:</i></p> <p><i>1. Forma 1: Vlerësim me kolokviume dhe projekt</i></p> <p><i>2. Forma 2: Vlerësimi me provimin përfundimtar.</i></p> <p>Forma 1:</p>		

	<p><i>Në formën e parë të vlerësimit “Vlerësimi me kolokviume dhe projekt” studenti vlerësohet në katër aktivitete që realizohen gjatë ligjëratave:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <i>1. Kolokviumi 1 (35%), vlerësim individual</i> <i>2. Kolokviumi 2 (35%), vlerësim individual</i> <i>3. Veprimtaria në klasë (10%), vlerësim individual</i> <i>4. Projekti (20%), vlerësim në grup.</i> <p><i>Nëse studenti nuk është i kënaqur me vlerësimin e arritur sipas formës 1, atëherë ai mund t'i nënshtrohet vlerësimit sipas formës 2 për të marrë një vlerësim më të lartë.</i></p> <p>Forma 2: <i>Nëpërmjet provimit përfundimtar studenti mund të arrijë maksimumi 70% të pikëve nga gjithsej 100 pikë.</i></p> <p><i>Pjesa tjetër e pikëve prej 20% duhet të plotësohet me punë në grup në Projekt, aktivitet që kryhet gjatë ligjëratave.</i></p> <p><i>Në Kolokviumin 1, Kolokviumin 2 dhe provimin përfundimtar, vlerësimi i studentëve do të bëhet përmes një formulari vlerësimi, i cili duhet të plotësohet individualisht nga studenti. Formulari i vlerësimit do të përmbajë 5 detyra përmes të cilave do të vlerësohen rezultatet e të nxënës të studentit.</i></p> <p><i>Aktiviteti në klasë nënkupton angazhimin e studentit në trajtimin e çështjeve të diskutuara në klasë, gjatë ligjëratave.</i></p> <p><i>Projekti (20%), vlerësim në grup: është një aktivitet në të cilin nxënësit zbatojnë njohuritë e marra në një projekt konkret. Realizohet në grupe me nga 3 ose 4 studentë të cilët janë të detyruar të kryejnë veprimtarinë, ta dokumentojnë dhe t'ia paraqesin pedagogut të lëndës.</i></p> <p><i>Vlerësimi:</i></p> <p><i>91-100 pikë – nota 10 (dhjetë)</i> <i>81-90 pikë – nota 9 (nëntë)</i> <i>71-80 pikë – nota 8 (tetë)</i> <i>61-70 pikë – nota 7 (shtatë)</i> <i>51-60 pikë – nota 6 (gjashtë)</i> <i>0-50 pikë – Studenti përsërit provimin</i></p>
Raporti i teorisë dhe praktikës:	80% Teori; 20% Praktikë
Literatura	
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> <i>1. Kenneth C. Laudon & Jane P. Laudon, “Management Information Systems: Managing the Digital Firm” 13th(2014) Edition, 2014</i>

	2. Elizabeth Hardcastle; <i>BUSINESS INFORMATION SYSTEMS</i> ; Liber falas online.
Literatura shtesë:	1. Haag & Cummings & Philips :” <i>Management Information Systems for the Information Age</i> ”, McGraw Hill, 2007
Plani i dizajnuar i mësimit	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	<i>Objektivi i lëndës- Syllabusi;</i>
Java e dytë:	<i>Hyrje në Informatikën e biznesit , Si Informatika është duke e transformuar botën e biznesin dhe mënyrën e vendimmarrjes. Trendet që ndikuan në botën e biznesit: Cloud Computing, Platforma e biznesit digjital mobil, Big Data dhe Rrjetet sociale.</i>
Java e tretë:	<i>Sistemet e Informacionit, definimi i tyre; Hyrje në Management Information System(MIS); Te rejat ne MIS qe ndryshuan mënyrën e te berit biznes dhe menaxhimin e kompanive te biznesit;</i>
Java e katërt:	<i>E dhëna dhe Informacioni; Struktura dhe komponentët e MIS: Konceptet e përgjithshme të TIK dhe njerëzit Objektivat strategjike të biznesit të arritura nga Sistemet e Informacionit.</i>
Java e pestë:	<i>Resurset njerëzore dhe procedurat</i>
Java e gjashtë:	<i>Kollokvium i parë</i>
Java e shtatë:	<i>Hardueri dhe Softueri</i>
Java e tetë:	<i>Bazat e te dhënave</i>
Java e nëntë:	<i>Teknologjia e rrjetit dhe telekomunikacionit Interneti.</i>
Java e dhjetë:	<i>Llojet e sistemeve te informacionit dhe dizajnimet konceptual i tyre;</i>
Java e njëmbëdhjetë:	<i>Implementimi, vlerësimi dhe mirëmbajtja e Sistemeve të Informacionit</i>
Java e dymbëdhjetë:	<i>Inteligjenca biznesore. Tregtia elektronike dhe biznesi elektronik, Qeverisja elektronike.</i>
Java e trembëdhjetë:	<i>Kollokvium i dytë</i>
Java e katërbëdhjetë:	<i>Vizitë studimore në një kompani</i>
Java e pesëmbëdhjetë:	<i>Prezantimi i projekteve dhe hulumtimeve.</i>
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
<i>Vijueshmëria e rregullt në ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme, si dhe angazhimi aktiv në diskutim dhe zgjidhje të detyrave. Mos pengimi i procesit mësimor duke i mbajtur të shkyçur telefonat celularë ose në gjendjen “pa zë”.</i>	